




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

DATË/A:	29.11.2023
PËR/ZA/TO:	YessPharma Sh.P.K.
Cc:	Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	Berat Marmullaku, Udhëheqës i Div. Prokurimit 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.11.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik YessPharma Sh.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative te QKUK-së"** Lot: 3 dhe 7, me Nr. të Prok: 206-23-11488-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si e jashtë afatshme ankesa e OE ankues YessPharma Sh.P.K, e datës: 27.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative te QKUK-së"** Lot: 3 dhe 7, me nr. të prokurimi: 206-23-11488-1-1-1, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: YessPharma Sh.P.K, ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me date 27.11.2023.

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

**Nenin 60.1(a) i Rregullave të prokurimit publik**

*Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*

**Kronologjia**

Autoriteti Kontraktues, ka shpallur aktivitetin e prokurimit me date 25.10.2023.

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve ishte 20.11.2023.

Me date 15.11.2023 është parashtruar kërkesë për rishqyrtim nga një OE tjetër.

Me date 22.11.2023 është nxjerr vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim të OE tjetër dhe është shtyrë afati për hapjen e ofertave me datë 05.12.2023.

Ne perputhje me nenin 63.1.1 (b), i cili nen përcakton "Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit" Ministria e Shëndetësisë me date 23.11.2023, ka publikuar Njoftimin mbi Korgjimin e procedurës dhe ka shtyrë afatin e dorëzimit deri me date 05.12.2023.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e juaj është dorëzuar me date 27.11.2023.

Ne perputhje me nenin 60.1. (a), kërkesa e juaj për rishqyrtim është dorëzuar jashtë afatit kohor sepse

*afati prej se paku 5 ditëve nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*

ZPP, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike :**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.